

URBALB CONSTRUCTION SH.P.K.
RRUGA RUGA DERVISH HIMA, PALLATI
AMBASADOR 3, KATI 8, AP. NR. 3 DHE 4, NJESIA BASHKIAKE NR.2
NUIS M02415022S

VENDIM

I

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më datë 11.03.2021, ora 10.00, në selinë e shoqërisë UrbAlb Construction Sh.p.k. me NUIS M02415022S (më tej referuar si "Shoqëria"), u mbajt Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me të pranishëm:

- **MANETCI sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Njesia Bashkiake Nr.2, Rruga Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, kati 8, Ap.nr. 3 dhe 4, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: K22203004A, përfaqësuar nga administratori Z. Erion Avram, shtetas shqiptar, lindur më 12.06.1978, në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 030548648, dhe me numër personal H80612140L, - ortake e Shoqërisë dhe zotëruese e 100% (njëqind përqindje) të kuotave të kapitalit themeltar të saj;

Z. Erion Avram i cili merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton znj. Rozana Kodrari, e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit. Kryetari i Asamblesë pasi deklaroi vullnetin e Ortakëve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, e deklaroi Asamblesën e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim

RENDI I DITËS

- I. **MIRATIMI I ZMADHIMIT TË KAPITALIT TË SHOQËRISË**
- II. **MIRATIMI I NDRYSHIMIT TË NENIT 5 TË STATUTIT TË SHOQËRISË**

Kryetari i Asamblesë në lidhje me pikën e parë dhe të dytë në Rend të Ditës parashtroi se për qëllime operacionale Ortaku i Vetëm ka kontribuar në para në shoqëri në një vlerë prej 24,724,000 LEK (njëzet e katër milionë e shtatëqind e njëzet e katër mijë lekë) me datë 25.01.2021. Duke qenë se kërkohet kapitalizimi i kontributeve të dhëna nga Ortaku, lind nevoja për miratimin e rritjes së kapitalit nëpërmjet kontributit në para të Ortakut të Vetëm me një vlerë të përgjithshme totale prej 24,824,000 LEK (njëzet e katër milionë e tetëqind e njëzet e katër mijë lekë). Për sa më sipër është e nevojshme që vlera e përgjithshme e kapitalit të reflektohet dhe në Statutin e Shoqërisë.

Pas një vlerësimi të kujdesshëm të çështjes së Rendit të Ditës, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë:

VENDOSI:

- A. Të miratojnë zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë nëpërmjet kontributit në para në vlerën prej 24,724,000 LEK (njëzet e katër milionë e shtatëqind e njëzet e katër mijë lekë).
- B. Zmadhimi i kapitalit është i shlyer plotësisht nga Ortaku i Vetëm nëpërmjet derdhjes bankare.
- C. Si rezultat i miratimit të Zmadhimit të Kapitalit sipas pikave (A) dhe (B), kapitali i Shoqërisë, nga 100 0 Lekë do të bëhet **24,824,000 LEK (njëzet e katër milionë e tetëqind e njëzet e katër mijë lekë).**
- D. Të miratojnë ndryshimin e nenit nr 5 të Statutit sipas Aneksit A bashkangjitur.

Për sa më sipër, autorizohet Administratori i Shoqërisë, të kryejë të gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit personalisht ose nëpërmjet autorizimit të tjerëve.

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 10.30.

Ky procesverbal i Asamblesë së Ortakut të Vetëm të "UrbAlb Construction" sh.p.k mbahet në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

KRYETARI



Z. Erion Avram

SEKRETARI

Znj. Rozana Kodrari

